



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024 TË
BASHKISË SHKODËR ”**

Konsultim publik : *Banoret e Lagjes Nr.4-Lagje nr.5*

Data : *03.11.2021*

Ora : *13.00*

Vendi: *Salla e Këshillit Bashkiak*

Numri i pjesëmarrësve: *Numri i pjesëmarrësve 37, nga të cilat 4 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: *Draft projekt plani buxhetor afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Kryetare e bashkisë znj. Voltana Ademi, Kryetare e Këshillit Bashkiak znj. Brisela Kadija, Kordinator për Njoftimin dhe Konsultimin me Publikun z. Fisnik Lutfija, Inspektorë te lagjeve 4 dhe 5, banorë të lagjeve, përfaqësues të drejtorive përkatëse të bashkisë Shkodër, si dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Takimi bashkë-drejtohet nga Kryetare e bashkisë Znj. Voltana Ademi dhe Kryetare e Këshillit Bashkiak të cilat bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjeguan qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtuan pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Udhëzuan për mënyrën e organizimit dhe mbarëvajtjes së takimit, me qëllim arritjen në përfundime dhe rekomandime konkrete për përmirësim.
- ✦ Koordinuan diskutimin ndërmjet pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me fushat e konsultuara si më poshtë vijon :

I: ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZE, i MESEM i PERGJITHSHEM, PROFESIONAL

1. Fjalën e merr **Znj.Arjana Baci**, drejtore kopshti”Ismet Sali Brucaj”e cila vlerëson punën e bërë deri tani. Ajo shprehet se është ndërhyrë në rikonstrukcion, në rrjetin elektrik,n ë infrastrukturë por edhe në kapacitetet njerëzore.Ajo kërkon:
 - a. Një mëmyrë financimi për pajisjen me lodra të ndryshme në përmirsimin e mësimdhenies.
 - b. Sistemi i ngrohjes është shumë i amortizuar.Është e nevojshme të ketë një system qëndror ngrohjeje.
 - c. Verifikimin e fëmijëve me aftësi ndryshe.
2. **Z.Gjergji**, banor i lagjes nr.5 propozon:
 - a. - Shkolla “Edit Durham” ka nevojë për riparim sinjalistikë, të rritet siguria për fëmijët.
3. **Përfaqësues të personave me aftësi ndryshe** propozojnë:
 - a. Rregjistrim në kopësht i fëmijëve me aftësi ndryshe.(të verifikohet edhe numri i tyre)
 - b. Për fëmijet me aftësi ndryshe të ketë mësues mbështetës të specializuar.
4. **Z.Sokol Zaimaj**, zv.drejtor shkolla “Dëshmorët e Prishtinës” merr fjalën dhe shprehet se vlerëson lëvizjen e rojeve të shkollave dhe mënyrën se sip o punohet me stafin mbështetës në Shkolla.Kjo ka ndikuar pozitivisht, po ashtu shkolla është furnizuar me dru për këtë vit shkollor, por mendon që ka akoma nevojë për ndërhyrje. Ai propozon:
 - a. Të ndërhyhet në infrastrukturën e shkollës si dhe të riparohet asfalti jashtë godinës.
 - b. Të rregullohet rrjeti elektrik sepse ka problem.
 - c. Të rregullohen vendparkimet për mesuesit sepse shpeshherë ka patur konflikte dhe gjoba.
 - d. Të punohet ne lulishten e shkollës
 - e. Klasat duhen lyster,të pakten të financohet boja.
5. **Z.Gjergji**, banor i lagjes nr.5 mendon që duhet të shihet edhe mundësia e punësimit të prindërve, për shërbime të ndryshme.Ai propozon:
 - a. - Vendosjen e Rampave në shkolla.
 - b. - Të punohet për gjelbërimin e shkollave.Ai propozon që ky shërbim të futet në kontratën e shërbimit të gjelbërimin.

II: MENAXHIMI i MBETJEVE

Z.Ademi merr fjalën dhe shtron pyetjen në lidhje me shqetësimet dhe problematikat e zonës në lidhje me mbetjet. Ajo kërkon të dijë nëse shërbimi është i kënaqshëm dhe a ka nevojë për shtim të konteinerëve dhe dhe të frekuencës së shërbimit

1. **Z.Fran Prendaj** shprehet se ka problem me ujin në zonen e tij të banimit.
2. **Z.Gjergji**, banor i lagjes nr.5 rimerr fjalën dhe propozon që:

- a. kontienerët e mbeturinave të vendosen ku kanë qënë, sepse vetë banorët kanë kundërshtuar dhe nuk i lënë në vendet e caktuara dhe hedhin edhe mbetje krasitjesh dhe inertesh.Por shprehet i kënaqur me shërbimin.
3. **Z.Dodë Mehmetaj** vëren:
 - a. Tek pallatet tek fusha e druve, ka nevojë për përmirësim shërbimi. Mendoj që duhet rritur frekuenca e pastrimit.
 4. **Z.Zaimi** merr fjalën përsëri dhe shprehet se
 - a. rruga nga Ura e Thive deri tek Arra e madhe është pastruar, por zakonisht perreth koshave nuk pastrohet. Mbetjet hidhen nga punëtorët në KUB. Prandaj ka nevojë për përmirësim të shërbimit në atë zonë.
 - b. Propozoj që gjelbërimi shkollave të shikohet mundësia që të futet në kontratën e gjelbërimit publik.
 5. **Z.Ardian Kimca**, banor rrugës Mirash Ivanaj propozojnë:
 - a. Pajisjen me kosha në lagjen e tij,sepse ka një zonë prej 2 km që nuk ka kosha fare,vetëm dy kosha në gjysëm të rrugës aspak të aksesueshëm për banorët.
 - b. Pilotim për ndarjen e mbeturinave.

III: NDRICIMI RRUGOR

Znj.Ademi: Cilat janë nevojat?nKu ka nevojë të shtohet shërbimi,etj?

1. **Z.Vehbi**,banor i lagjes nr.4 rrugica e Boricëve, propozon:
 - c. Të shtohet shërbimi i ndriçimit tek pallatet e zonës ku banon. “Nuk ka aspak ndiçim aty”, shprehet ai. Ai thotë që banorët kanë bërë edhe kërkesë, por deri tani nuk ka patur ndërhyrje.
2. **Z.Dode Mehmetaj** ndërhyr dhe thotë që ndricimi është problem në gjithë unazën lindore. Gjithcka është gati por ka defekt. Kush e ka për kompetencë
3. **Edhe Z.Armando Buzukja, banor i rrugës Marinaj** shprehet se ka problem me ndriçimin në zonën ku banon.Vetë banorët atje kanë investuar privatisht, Kanë bërë edhe kërkesa pranë bashkisë. Ai propozon:
 - a. Të ndërhyhet në zonë sepse për momentin nuk ka ndriçim.
4. **Z.Pal Pepaj**,inspektor i lagjes nr.5 dhe shprehet se:
 - a. Duhet zgjidhur problem me ndricimin e unazës lindore.
 - b. Lagjja është në përgjithësi e ndricuar kënaqshëm.
 - c. Tek Rr.2Dom Ndre Zadeja2, pranë shkollës “Miqësia”ka nevojë të shtohen shtyllat elektrike.
 - d. Rr.”Marinaj”, ka nevojë të pajiset me ndriçuesat të rinj.

- e. Duhet shtuar të paktën katër shtylla në fund të Rr.”Revolucioni Austro-Hungarez”.
 - f. Në Qafëhardhi ka dy ndricuesa privat si tek Qendra shëndetësore dy prozhektora rrinë të ndezur gjithë kohën.Situata është në verifikim.
5. **Z.Gjergji** informon se edhe pranë rrugës tek Stacioni i mallrave ka nevojë për ndricuesa sepse shtyllat janë.
6. **Z.Altin Salih**i, përgjegjës i njësisë së ofrimit të shërbimit të ndriçimit rrugor informon se::
- a. Rr.e Boricve kërkon investim të ri per lidhje kontrate. Kjo është parashikuar në projekt buxhetin e vitit 2022.
 - b. Akoma nuk ka përfunduar çështja për ndriçimin tek unaza e qytetit, por jemi të gatshëm për të marrë përsipër mirëmbajtjen dhe pagesën e energjisë elektrike, sapo të na dorëzohet nga Autoriteti rrugor shqiptar investimi i realizuar para disa vitesh, pa martur asnjë detyrim të energjisë elektrike, pasi kjo është jo në përgjegjësinë e Bashkisë. Bashkia Shkodër, nuk mund të marrë përsipër detyrimet e prapambetura, për investime të realizuara nga institucionet e tjera. .I jemi drejtuar Autoritetit rrugor shqiptar edhe në menyrë shkresore.
 - c. Edhe Rr.”Marinaj” kërkon investim dhe duhet të parashikohet në PBA 2022-2024

IV:RRJETI RRUGOR

1. Fjalën e merr **Z.Pal Pepa** dhe informon se :
- a. Se në lagjen “Marlula”,rr.”Besa e Prekalit” ka nevojë për rikonstrukcion.
 - b. Gjendja e rrugëve në Lagjen nr.5 është në përgjithësi e mirë,janë të rregulluara.
 - c. Në blloqet e banimit tek lagje 5”Marlula” është punuar, po shtrohen tre rrugë dhe është zgjidh problemi i kullimit.
 - d. Edhe tek rrugët që fillojnë nga Rr.”Ded Gjo Luli” dhe mbarojnë tek unaza lindore kanë nevojë për ndërhyrje dhe është shumë e rëndësishme sepse zgjidh problemin e përmbytjeve nga shirat.Keshtu realizohet edhe kullimi. Disa nga këto rrugë janë:1.Besa e Prekalit, 2.Frang Bardhi, 3.Dom Ndre Zadeja, 4.Kaprej dhe 5.rr.Martirëve tek varrezat katolike.
2. **Z.Briken Tuzi** merr fjalën dhe kërkon qe në lagjen “Vekshar”
- a. Të vendoset një bum në unazë, sepse ka rrezikshmëri nga shpejtësia e makinave në zonë.
 - b. Të ndërhyhet tek rruga e Tepes sepse ekzistuesja është prishur.
3. **Z.Skender Nasja**,banor rrugen “Dervish Beg” propozon:
- a. Tek rruga “Dervish Beg”,saktësisht rruga e “Bebeziqve”,është e degraduar,dhe ka nevojë urgjente për ndërhyrje.
 - b. Edhe pranë shtëpisë së “Dan Hasanit” ka gjithmonë makina që bllokojnë rrugën.Madje edhe në trotuar.

4. Qytetar

- a. Tek rrugica e “Boricve”, kërkohet ndërhyrje në sheshim të oborrit mes pallateve, ka nevojë edhe për pastrim nga dheu, ferrat etj.

5. Tjetër qytetar, b. **Z. Ernest Marku**, banor i lagjes nr.5 propozon që:

- a. rruga “Gjon Gazulli” të jetë prioritet për investim në këtë buxhet, sepse është një rrugë që nuk ka pasur asnjëherë investim dhe është tejet e amortizuar. Aty ka aktivitet ekonomik dhe është shumë e rëndësishme edhe për punëtorët e fasonerive. Rruga ka një gjatësi rreth 300-350 m.

6. **Z. Ndoc Ashta**, administrator i njësisë administrative Shosh propozon:

- a. Ndërhyrje në rrugën “Marash Ivanaj”, rr. “Gjon Gazulli” sepse ka shumë biznese.
- b. Ka nevojë për KUZ dhe KUB, ndricim dhe asfaltim.
- c. Ka nevojë për mbulim me ujë të pijshëm.
- d. Disiplinimin e automjeteve sepse krijohen situata të pakëndshme shpeshherë.

7. **Z. Nikoll Avdija**, banor njëkohësisht inspektor i shërbimeve publike në lagjen nr. 5.

- a. Nderhyrje në rrugën “Suka e Kunores” tek blloku i ish fushës së drurëve.
- b. Meremetim e një pjese rruge tek Stacioni i trenit.

8. **Z. Renato Cardaku dhe Z. Armando Dermano** propozojnë ndërhyrje dhe investim në rrugët:

- a. Rruga “Roza Lein”
- b. Rruga “Pjetër Bogdani”
- c. Rruga “Cajupi”

9. **Z. Gjergj Mullisi**, banor në lagjen nr.5 propozon:

- a. Të ndërhyhet tek “Qafa e bishkazit”. Ka probleme me KUB, KUZ dhe mungon uji i pijshëm.

10. **Z. Dodë Mehmetaj** propozon

- a. Të shihet me prioritet rruga pranë shkollës austriake, ka një pjesë të pakalueshme që lidhet me unazën.
- b. Edhe rruga tek varrezat e dëshmorëve vazhdon të jetë problem.

11. **Z. Zaimaj** në lidhje investimet në rrugë, propozon

- c. Të rishikohet rrugica “Dom Ndre Zadeja” sepse ka probleme me kuotat, dhe zona mbulohet me ujë.
- d. Edhe tek Ura e Thive duhen verifikuar pemët, që kanë prishur trotuaret.

12. Qytetar , banor i lagjes Nr.5

- e. Kërkoj që të investohet tek rruga “Malet Tona” pasi është një rrugë tejet e amortizuar dhe ka nevojë për investim.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

Fisnik Lutfija








BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektit planit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJA NR.4 DHE LAGJA NR.5

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Edmond Durrës	Artaçaj	Mbushës	43	Lagja 5	punëtor	-
2	Ilir Artaçaj	Artaçaj	-11-	62	5	inspektor	Bogdaj
3	Artaçaj	Artaçaj	-11-	31	-11-5	in. elektrik	Bogdaj
4	Angjelin	Markollaj	-11-	50	4	inspektor	Daskaj
5	Paq	Peqaj	-11-	54	5	inzhinier	Bogdaj
6	Artaçaj	Bogdaj	♀	53	-11-4	Artaçaj	Bogdaj
7	RENATO	ARMEND	MA	29	Lagja 5	ekonomist	Privat
8	GJONIN	STREJA	M	62	Lagja 5	punëtor	Privat
9	ZEF	LAZRI	MA	65	Lagja 5	punëtor	-
10	PETER	LAZRI	M	59	Lagja 5	trapeztor	Privat
11	ARMANDO	BUSUQJA	M	55	Lagja 5	DISHES	PRIVAT
12	Veljani	Artaçaj	M	40	Perona 4	BUSUQJA	PRIVAT
13	Skender	NOAJ	MA	68	Perona 4	ekonomist	

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJA NR.4 DHE LAGJA NR.5

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Sahal	Zaimnej	M	57	duge 5	metues	P. Pajdhej
15	Altin	Yoshi	M	43	duge 5	Larte	Sipërmarës
16	Ferid	Geraj	M	43	Lagje 5	Larte	Sipërmarës
17	Ernest	Harciu	M	62	Lagje 5	Lartë	Oficer
18	KOZETA	JANA	F	34	Lagje 5	Financiere	KESH
19	Naim	Pajdhej	M	36	Lagje 5	Rejz sikall	
20	Sergj	Babouj	M	63	-4-	Bauor	Korburante
21	ARSJAN	KINISA	M	50	LAGJA -4	LARTE	ËRNES
22	Amel	Harciu	M	52	5	Safulba	
23	Dada	Mohmetaj	M	66	Rajin 5	Apr. End	Rejzant
24	Sahal	Mullisi	M	58	LAGJA 5	Pr. Bujar	qel
25	Abdullah	Doda	M	60	sipërmarës	inspektor gj. ishball	ishball
26	Edmond	Sumce	M	31	lagje 5	Inspektor gj.	Bashkia Shkodër

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

Sergj Mullisi gj